

Right Before Our Eyes

By Elder Ronald A. Rasband
Of the Quorum of the Twelve Apostles

Pikërisht Përpara Syve Tanë

Nga Plaku Ronald A. Rasband,
i Kuoromit të Dymbëdhjetë Apostujve

April 2025 general conference

The Church of Jesus Christ of Latter-day Saints is growing in members and families, missions and missionaries, meetinghouses and temples.

Brothers and sisters, I am so grateful to be with you. We love you, we are grateful for you, and we feel blessed by your prayers.

President Russell M. Nelson said at our last conference: “Do you see what is happening right before our eyes? I pray that we will not miss the majesty of this moment! The Lord is indeed hastening His work.”

Hastening His work. “Hastening” is a word that matters. It suggests moving quickly, accelerating, and even urgency. In the growth of the Church and the plan of Christ, hastening is happening. And we are all a part of it.

In April 1834 in Kirtland, Ohio, the Prophet Joseph Smith gathered all who held the priesthood into a little schoolhouse about 14 feet (4.3 m) square. We could fit dozens of those schoolhouses in this Conference Center, with room to spare. Joseph Smith said, “It is only a little handful of Priesthood you see here tonight, but this Church will fill North and South America—it will fill the world.”

That prophecy is being fulfilled “right before our eyes.” The Church of Jesus Christ of Latter-day Saints is growing in members and families, missions and missionaries, meetinghouses and temples, and in enrollment in our seminaries, institutes, and universities all around the world.

We are grateful to be on earth when the

Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme po rritet në numër anëtarësh e familjesh, misionesh e misionarësh, shtëpish të mbledhjeve e tempujsh.

Vëllezër e motra, sa mirënjohës jam që jam me ju! Ne ju duam, jemi mirënjohës për ju dhe ndihemi të bekuar nga lutjet tuaja.

Presidenti Rasëll M. Nelson tha në konferencën tonë të fundit: “A e shihni atë që po ndodh pikërisht përpara syve tanë? Lutem që të mos e humbasim madhështinë e këtij çasti! Zoti njëmend po e përshpejton veprën e Tij.”

Përshpejtimi i veprës së Tij. “Përshpejtimi” është një fjalë që ka rëndësi. Sugjeron lëvizjen me të shpejtë, rritjen e shpejtësisë dhe madje ngut. Në rritjen e Kishës dhe në planin e Krishtit, përshpejtimi po ndodh. Dhe ne të gjithë jemi pjesë e tij.

Në prill 1834, në Kirtland të Ohajos, Profeti Jozef Smith i mbledhi të gjithë ata që mbanin priftërinë, në një shtëpi të vogël, që ishte dhe shkollë, rreth 18 metra katrorë. Do të mund të futnim dhjetëra nga ato shtëpi shkolla në këtë Qendër Konferencë dhe prapë do të kishte vend bosh. Jozef Smithi tha: “Ju shihni vetëm një grusht njerëzish që mbajnë Priftërinë këtu sonte, por kjo Kishë do të mbushë Amerikën e Veriut dhe të Jugut – ajo do të mbushë botën.”

Ajo profeci po përmbushet “pikërisht përpara syve tanë”. Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme po rritet në numër anëtarësh e familjesh, misionesh e misionarësh, shtëpish të mbledhjeve e tempujsh, si dhe në regjistrimin në seminarët, institutet dhe universitetet tona anembanë botës.

Jemi mirënjohës që jemi në tokë kur Kisha

Church is increasing in numbers and influence, but more importantly in the hearts and lives of its members. We are known as disciples of Jesus Christ. We share our testimonies of Him, His Church, His ways, and His covenant path. We are His people, and He is our Savior.

I marvel at what President Nelson calls the “majesty of this moment” and express profound gratitude to the Lord for His work. I encourage us to stand tall as His disciples, eyewitnesses of the fulfillment of prophecy, both ancient and modern.

There are naysayers who shout, “Lo, here!” and ... ‘Lo, there!’” just as they did in the Prophet Joseph Smith’s time. However, they are and will be but mere footnotes in this noble work. Remember the words of Joseph Smith: “No unhallowed hand can stop the work from progressing; persecutions may rage, ... but the truth of God will go forth boldly, nobly, and independent, till it has penetrated every continent, visited every clime, swept every country, and sounded in every ear, till the purposes of God shall be accomplished, and the Great Jehovah shall say the work is done.”

In my assignments this year, I have had a front-row seat to the Lord hastening His work. The Church is building temples at an unprecedented pace, giving more members an opportunity to worship in the house of the Lord. Second, missionary work is gathering record numbers to the fold of the Good Shepherd, Jesus Christ. And third, Church education in many configurations is at a new high in teaching those who “seek this Jesus.”

Today the Church has 367 temples in various stages of design, construction, or operation. And for what purpose? The answer is proclaimed on each temple: “Holiness to the Lord.” The temple opens the way to the highest blessings our Father in Heaven has for each one of us. Brothers and sisters, we are hastening our holiness as we live temple worthy, as we worship in the house of the Lord, and as we make covenants with God for ourselves and on behalf of our ancestors on the other side of the veil.

President Nelson has said: “The assaults of the adversary are increasing exponentially, in intensity and in variety. Our need to be in the temple on a regular basis has never been greater.

po rritet në numër dhe në ndikim, por me më shumë rëndësi, në zemrat dhe jetën e anëtarëve të saj. Ne njihemi si dishepuj të Jezu Krishtit. Ne japim dëshmitë tona për Të, Kishën e Tij, udhët e Tij dhe shtegun e Tij të besëlidhjeve. Ne jemi populli i Tij dhe Ai është Shpëtimtari ynë.

Mahnitem me atë që Presidenti Nelson e quan “madhështi[a] e këtij çasti”, dhe i shpreh mirënjohje të thellë Zotit për veprën e Tij. Ju nxit që të qëndroni plot guxim si dishepuj të Tij, dëshmitarë okularë të përmbushjes së profecisë, si të lashtë ashtu edhe bashkëkohore.

Ka kundërshtues që bërtasin: “Shih, këtui! ... ‘Shih, atje!’” pikërisht sikurse bënë në kohën e Profetit Jozef Smith. Sidoqoftë, ata janë dhe do të jenë veçse thjesht ca poshtëshënime në këtë vepër fisnike. Mbajini mend fjalët e Jozef Smithit: “Asnjë dorë mëkatore nuk mund ta ndalojë punën të përparojë; përndjekjet mund të egërsohen, ... por e vërteta e Perëndisë do të shkojë përpara me guxim, me fisnikëri dhe e pavarur derisa ajo të ketë përshkuar çdo kontinent, të ketë vizituar çdo rajon, të futet në çdo vend dhe të jetë dëgjuar nga çdo vesh, derisa qëllimet e Perëndisë të përmbushen dhe Jehova i Madh të thotë se puna u krye”.

Në detyrat e mia këtë vit, e kam dëshmuar i ulur në rresht të parë përshpejtimin që Zoti i ka bërë veprës së Tij. Kisha po ndërton tempuj me një ritëm të paparë, duke u dhënë mundësi më shumë anëtarëve për të adhuruar në shtëpinë e Zotit. Së dyti, puna misionare po mbledh një numër rekord njerëzish në tufën e Bariut të Mirë, Jezu Krishtit. Dhe së treti, arsimimi i Kishës në shumë mënyra është në një nivel të ri, të lartë për mësimdhënien ndaj atyre që e “kërko[jnë] këtë Jezus”.

Sot Kisha ka 367 tempuj në faza të ndryshme të projektimit, ndërtimit ose funksionimit. Dhe për çfarë qëllimi? Përgjigjja shpallet mbi secilin tempull: “Shenjtëri Zotit”. Tempulli hap udhën drejt bekimeve më të larta që Ati ynë në Qiell ka për secilin prej nesh. Vëllezër e motra, ne po e përshpejtojmë shenjtërinë tonë teksa jetojmë të denjë për tempullin, teksa adhurojmë në shtëpinë e Zotit dhe teksa bëjmë besëlidhje me Perëndinë për veten tonë dhe në emër të paraardhësve tanë në anën tjetër të velit.

Presidenti Nelson ka thënë: “Sulmet e kundërshtarit po shtohen në mënyrë eksponenciale, për nga intensiteti dhe larmia. Nevoja jonë për të qenë në tempull rregullisht dhe shpesh nuk

I plead with you to take a prayerful look at how you spend your time.”In His house we can feel the Lord’s hallowed presence and transcendent peace.

Last year I was privileged to preside at the dedication of the Mendoza Argentina Temple. In my message, I referred to Elder Melvin J. Ballard’s 1926 prophecy that the work of the Lord would grow slowly for a time in South America, “just as an oak grows slowly from an acorn. It will not shoot up in a day,” but thousands would join the Church, and the nations of South America would become “a power in the Church.”I saw that prophecy fulfilled right before my eyes.

Mendoza, once a small acorn, has become a mighty oak. That growth is being repeated across continents and isles of the sea.

We see the Lord hastening His work in missions. In 2024, 80,000 missionaries were serving in 450 missions. Thirty-six of those are new missions. Last year missionary work brought over 308,000 new members into the Church. More than numbers, the spirit of the gathering is bringing souls to Jesus Christ and His gospel.

I think of the Apostles Brigham Young and Heber C. Kimball, who in 1839 set off as missionaries to the British Isles. They were ill; they left families sick and destitute. Nevertheless, the two climbed into a wagon, and while still in sight of their loved ones, Heber said, “Let’s rise up and give them a cheer.” The two struggled to their feet and shouted, “Hurrah, hurrah for Israel.”

I saw that same enthusiasm for the Lord’s work in Lima, Peru, when I met with missionaries from the missionary training center and missions in Lima. What a sight! I saw the hastening right before my eyes. There are now seven missions in just the city of Lima.

At the end of our meeting, the missionaries had a special surprise for me. They rose up and cheered, “Hurrah for Israel.” I will never forget that moment; I wish all of you could have been there. Right before my eyes were missionaries who had set aside “the things of this world” to serve the Lord and help hasten His coming.

We see the Lord hastening educational opportunities for our members and even those not of our faith around the world. One of the things

ka qenë kurrë më e madhe. Ju përgjerohem ta merrni parasysht plot lutje mënyrën se si e shpenzoni kohën tuaj.”Në shtëpinë e Tij, ne mund ta ndiejmë praninë e shenjtë dhe paqen e mrekullueshme të Zotit.

Vitin e kaluar isha i privilegjuar që të kryesoja në përkushtimin e Tempullit të Mendozës në Argjentinë. Në mesazhin tim, iu referova profesitë së Plakut Melvin J. Ballard, të vitit 1926, që vepra e Zotit do të rritej ngadalë për ca kohë në Amerikën e Jugut, “ashtu si një lis rritet ngadalë nga një lende. Nuk do të rritet papritur në një ditë”, por mijëra veta do të bashkoheshin me Kishën dhe kombet e Amerikës së Jugut do të bëheshin “një fuqi në Kishë”. E pashë të përmeshej ajo profeci pikërisht përpara syve të mi.

Mendoza, dikur një lende e vogël, është bërë një lis i fuqishëm. Ajo rritje po përsëritet nëpër kontinentet dhe ishujt e detit.

Ne e shohim Zotin ta përshpejtojë veprën e Tij në misionet. Në vitin 2024, 80 000 misionarë po shërbenin në 450 misionet. Tridhjetë e gjashtë prej tyre, janë misionet të reja. Vitin e kaluar, puna misionare solli mbi 308 000 anëtarë të rinj në Kishë. Më shumë se numrat, fryma e mbledhjes po sjell shpirtin e Jezut Krishtin dhe ungjillin e Tij.

Mendoj për Apostujt Brigam Jang dhe Hibër C. Kimball, të cilët në vitin 1839 u nisën si misionarë drejt Ishujve Britanikë. Ata ishin të sëmurë; i lanë familjet të sëmura e të mjeruara. Megjithatë, ata të dy u ngjitën në një karrocë dhe, ndërsa ende i shihnin njerëzit e tyre të dashur, Hibëri tha: “Le të çohemi dhe t’iu japim një përshëndetje”. Të dy u ngritën me vështirësi në këmbë dhe bërtitën: “Urra, urra për Izraelin!”

Pashë po të njëjtin entuziazëm për veprën e Zotit në Limë të Perusë, kur u takova me misionarët nga qendra e trajnimit të misionarëve dhe nga misionet në Limë. Çfarë pamjeje! E pashë përshpejtimin pikërisht përpara syve të mi. Tani ka shtatë misionet vetëm në qytetin e Limës.

Në fund të takimit tonë, misionarët patën një surprizë të veçantë për mua. U ngritën në këmbë dhe thirrën: “Urra për Izraelin!” Nuk do ta harroj kurrë atë çast; do të doja që ju të gjithë të mund të kishit qenë atje. Pikërisht përpara syve të mi ishin misionarët që kishin lënë mënjane “gjërat e kësaj bote” për t’i shërbyer Zotit dhe për të ndihmuar që të përshpejtohet ardhja e Tij.

Ne e shohim Zotin të përshpejtojë mundësitë arsimore për anëtarët tanë dhe madje edhe për ata që nuk janë të besimit tonë nëpër botë. Njëra

that distinguishes us as a church is our emphasis on education. The Lord commanded in the early days of the Restoration to “seek learning, even by study and also by faith.” That is happening today and is worthy of a resounding “hurrah.”

Currently more than 800,000 students worldwide are enrolled in seminary and institute, the highest enrollment in the history of the Church. Our youth gather in a variety of ways, from early-morning, daytime, and evening classes to online and in-home study. They are a mighty and righteous battalion, gaining strength from each other as they learn of Jesus Christ, follow, and testify of Him as the Son of God.

Last fall I spoke at a devotional to an arena full of seminary and institute students and their parents at the University of Utah. Their attendance said much about their desire to know and follow Jesus Christ. My message to those students was clear: Give the Lord equal time. I counseled them to balance their studies with true higher learning, even a study of “the Son of the living God.”

I ask the same of everyone today: Whatever is on your to-do list, give equal time, not spare time, to the Lord in personal scripture study, family study of Come, Follow Me, prayer, Church callings, ministering, partaking of the sacrament, worshipping in the temple, and pondering the things of God. Our Lord and Savior has said, “Learn of me ... and ye shall find rest unto your souls.” Take Him at His word. And give Him equal time.

President Nelson has said: “I plead with you to let God prevail in your life. Give Him a fair share of your time. As you do, notice what happens to your positive spiritual momentum.”

We see that momentum building at seminaries, institutes, and Church universities. In these environments, the Lord is a priority. So should He be in each one of our lives.

Another area that shows the growing reach of education in the Church is BYU–Pathway Worldwide. Across the world, enrollment has reached nearly 75,000 and continues to grow rapidly. Most are members, and more than one-third

nga gjërat që na dallon si kishë, është theksimi ynë tek arsimimi. Zoti urdhëroi në ditët e hershme të Rivendosjes: “Kërkoni të mësoni, madje me anë të studimit dhe gjithashtu me anë të besimit”. Kjo po ndodh sot dhe e meriton që të bërtasim një “urra” kumbuese.

Aktualisht, më shumë se 800 000 nxënës dhe studentë në të gjithë botën janë regjistruar në seminar dhe institut, regjistrimi më i madh në historinë e Kishës. Rinia jonë mbledhet në një larmi mënyrash, nga orët mësimore herët në mëngjes, gjatë ditës e në mbrëmje deri në orët mësimore në internet dhe të studimit në shtëpi. Ata janë një batalion i fuqishëm dhe i drejtë, që marrin forcë nga njëri-tjetri teksa mësojnë për Jezu Krishtin, e ndjekin Atë dhe dëshmojnë për Të si Biri i Perëndisë.

Vjeshtën e kaluar, fola në një takim shpirtëror në një pallat sporti plot me nxënës seminari dhe studentë instituti dhe prindërit e tyre në Universitetin e Jutës. Pjesëmarrja e tyre tregoi shumë rreth dëshirës së tyre për ta njohur e ndjekur Jezu Krishtin. Mesazhi im për ata studentë që i qartë: Jepini Zotit kohë të barabartë. I këshillova që të baraspeshonin studimet e tyre me të mësuarit e vërtetë, më të lartë, madje një studim për “Biri[n e] Perëndisë të gjallë”.

I kërkoj të njëjtën gjë çdo njeriu sot: Çfarëdo që është në listën tuaj “gjëra për t’i bërë”, jepini Zotit kohë të barabartë, jo kohën që ju ngelet, në studimin vetjak të shkrimeve të shenjta, studimin familjar të programit Eja, Më Ndiq, lutjet, thirrjet në Kishë, dhënien e shërbesës, marrjen e sakramentit, adhurimin në tempull dhe përsiatjen e gjërave të Perëndisë. Zoti dhe Shpëtimtari ynë ka thënë: “Mësoni nga unë ... dhe ju do të gjeni prehje për shpirtat tuaj”. Merreni për bazë fjalën e Tij. Dhe jepini Atij kohë të barabartë.

Presidenti Nelson ka thënë: “Ju lutem që ta lejoni Perëndinë të triumfojë në jetën tuaj. Jepini Atij një pjesë të mirë të kohës suaj. Ndërsa e bëni këtë, vërejeni se çfarë i ndodh hovit tuaj pozitiv shpirtëror.”

E shohim atë hov duke u ngritur në seminar, institutet dhe universitetet e Kishës. Në këto mjedise, Zoti është një përparësi. Po ashtu duhet të jetë Ai në jetën e secilit prej nesh.

Një fushë tjetër që tregon ndikimin në rritje të arsimimit në Kishë, është UBJ–Pathway Mbarëbotëror. Anëmbanë botës, regjistrimi ka arritur në afërsisht 75 000 veta dhe vazhdon të rritet me shpejtësi. Shumica janë anëtarë dhe më

are in Africa. Pathway is all about access to education. Completing the courses means access to employment, and access to employment means a better life for families and more opportunities to serve the Lord.

When I was meeting with stake leaders in Uganda, I learned that the entire stake presidency was enrolled in BYU–Pathway. The more prepared we are temporally and spiritually, the more we can thwart the adversary’s cunning attacks. Remember the words of Peter: “The devil, as a roaring lion, walketh about, seeking whom he may devour.”

I recognize that in the midst of the good news of the gospel, there are those who struggle, who have faith challenges, doubts, and questions that seem to have no answers. Brothers and sisters, Jesus Christ is the answer. Start with Him. Look for His hand in your life. Listen to Him. “Let not your heart be troubled,” He said in His last hours to His disciples before Gethsemane, before carrying His cross through the streets of Jerusalem, before Golgotha, where He completed His atoning sacrifice—what only He, the Begotten Son of God, could do.

Know that He understands. He took upon Himself all our sins, mistakes, misery, and very bad days that we might live again with our Father in Heaven in eternity. He has said, “Look unto me in every thought; doubt not, fear not.” Faith in Jesus Christ can lift you up and heal your wounded soul. Trust Him and you will hasten your return to “the arms of his love.”

I emphasize again the words of our living prophet: “Do you see what is happening right before our eyes? I pray that we will not miss the majesty of this moment! The Lord is hastening His work.” May we as disciples of our day shout, “Hurrah for Israel” as we prepare for the return of our Lord and Savior. In the name of Jesus Christ, amen.

shumë se një e treta janë në Afrikë. Pathway ka si qëllim kryesor qasjen ndaj arsimit. Përfundimi i kurseve do të thotë qasje ndaj punësimit dhe qasje ndaj punësimit do të thotë një jetë më e mirë për familjet dhe më shumë mundësi për t’i shërbyer Zotit.

Kur po takohesha me udhëheqësit e kунjit në Ugandë, mësova se e tërë presidenca e kунjit ishte regjistruar në UBJ–Pathway. Sa më të përgatitur të jemi materialisht dhe shpirtërisht, aq më shumë mund t’i pengojmë sulmet djallëzore të kundërshtarit. Mbajini mend fjalët e Pjetrit: “Djalli, sillet rreth e qark si një luan vrumbullues, duke kërkuar cilin mund të përpijë”.

E dalloj se mes lajmit të mirë të ungjillit, janë ata që hasin vështirësi, të cilët kanë sfida, dyshime dhe pyetje ndaj besimit që duken se nuk kanë asnjë përgjigje. Vëllezër e motra, Jezu Krishti është përgjigjja. Fillojeni me Të. Kërkojeni dorën e Tij në jetën tuaj. Dëgjojeni Atë. “Zemra juaj mos u tronditë”, – iu tha Ai në orët e fundit dishepujve të Tij përpara Gjetsemanit, përpara se të mbartte kryqin e Tij nëpër rrugët e Jerusalemit, përpara Golgotës, ku Ai plotësoi fljimin e Tij shlyes – gjë që vetëm Ai, Biri i Vetëmlindur i Perëndisë, mund ta bënte.

Dijeni se Ai kupton. Ai mori mbi veten e Tij të gjitha mëkatet tona, gabimet, mjerimin dhe ditët shumë të këqija, që ne të mund të jetojmë përsëri me Atin tonë në Qiell në përjetësi. Ai ka thënë: “Shihni tek unë në çdo mendim; mos dyshoni, mos kini frikë”. Besimi te Jezu Krishti mund t’ju ngrejë dhe ta shërojë shpirtin tuaj të plagosur. Kini besim tek Ai dhe ju do ta përshpejtoni kthimin tuaj në “krahët e dashurisë së Tij”.

I theksoj përsëri fjalët e profetit tonë të gjallë: “A e shihni atë që po ndodh pikërisht përpara syve tanë? Lutem që të mos e humbasim madhësinë e këtij çasti! Zoti po e përshpejton veprën e Tij.” Bërtitshim ne, si dishepuj të kohës sonë: “Urre për Izraelin!”, teksa përgatitemi për kthimin e Zotit dhe Shpëtimtarit tonë! Në emrin e Jezu Krishtit, amen.